

Bejons: "Kam menduar se kurrë nuk do të gjej të dashur"

Edhe pse sot pas saj çmenden miliona meshkuj, Bejons Noules si adoleshente ishte e bindur se kurrë nuk do të gjejë të dashur.

Këngëtarja, e cila sot është në martesë të lumtur me reperin Jay-Z-i, e ka pranuar se si e re kishte menduar se kurrë nuk do të gjejë burrë. Në të vërtetë, Bejonsi në atë periudhë të jetës aq shumë kishte punuar, sa shumë rrallë ishte shoqëruar me bashkëmoshatarë të saj, për çka kishte menduar se kurrë nuk do të gjejë të dashur.

“Kishte momente kur si adoleshente kam shikuar në dritare moshataret e mia duke dalë me të dashurit e tyre dhe kam menduar se unë kurrë nuk do ta gjej ndonjë të tillë. Thjesht, nuk kam mundur të dal jashtë, ndërsa askush nuk më ka ftuar. Kam punuar tepër shumë dhe atë me njerëz shumë më të moshuar se unë”, ka treguar Bejons. “Tani jam shumë e lumtur, sepse e kam gjetur personin e duhur. Nuk do ta ndërroja këtë me asgjë në këtë botë”, ka deklaruar Noules gjatë intervistës me ‘Sunday Mirror’./kosova-sot

Burimi:

<http://www.cdodite.com/20090519104258/Bejons-Kam-menduar-se-kurre-nuk-do-te-gjej-te-dashur.html>